

Aktivitetet dhe prioritetet e Misionit rreth barazisë gjinore

*Barazia gjinore është
e rëndësishme!*

[wo]men



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Mbështetje për gratë e reja në dialogun rajonal

Nga 2012, Misioni mbështet nismën (Follow Us), në kuadër të së cilës gra të shquara nga Prishtina dhe Beogradi takohen për aktivitete të përbashkëta në fushën e fuqizimit të grave dhe dialog. Në mbështetje të qëllimeve të tyre të përbashkëta, Misioni në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Serbi, ka organizuar tri edicione dhjetëditëshe të Akademisë së Dialogut për gratë e reja nga Prishtina dhe Beogradi në 2015, 2016 dhe 2017. Është themeluar edhe një Rrjet Alumni, ku marrin pjesë të diplomuarat e Akademisë dhe janë organizuar tryeza diskutimesh dhe punëtori për promovim të debateve qenësore rreth roleve gjinore dhe të drejtave të grave. Në 2018, Misioni do të vazhdojë të mbështes aktivitetet e nismës Na ndiqni dhe rrjetin Alumni të Akademisë të Dialogut.



Përfshirja e perspektivës gjinore në punën e mekanizmave të komuniteteve lokale


Në 2016, Misioni ka punuar me mekanizmat lokalë të komuniteteve për t'i thelluar njohuritë e tyre rreth mënyrave për promovim të barazisë gjinore përmes punës që bëjnë. Përfaqësues të komiteteve për komunitete, zyra komunale për komunitete dhe kthim, nënkryetarë dhe zëvendëskryesues të kuvendeve komunale morën pjesë në pesë tryezat e mbajtura ku mësuan rreth hapave praktikë që mund t'i ndërmarrin për ta shtuar nivelin e përfaqësimit gjinor në mekanizmat për komunitete, si dhe në çfarë mënyre mund të sigurojnë që si burrat ashtu dhe gratë të kenë njëllëj dobi nga puna e këtyre mekanizmave. Në 2017, Misioni mbajti një punëtori më të avancuar me zyrat komunale për komunitete dhe kthim.

Barazia gjinore në shkolla

Duke ditur rëndësinë e mjediseve shkollore që marrin parasysh nevojat dhe sfidat e veçanta me të cilat përballen vajzat dhe djemtë, në 2016 dhe 2017, Misioni ka organizuar 20 seanca informuese për barazinë gjinore me mësimdhënës/e dhe drejtorë/esha të shkollave nëpër komuna të ndryshme të Kosovës. Synim i këtyre takimeve ka qenë vetëdijesimi rreth mënyrave në të cilat mund të promovohet barazia gjinore në sektorin e arsimit, përfshirë luftën kundër stereotipave dhe normave gjinore që mund të shpiejnë në pabarazi, si dhe rolin e institucioneve arsimore në identifikimin e rasteve të mundshme të dhunës në familje dhe referimin e tyre në Policinë e Kosovës. Përveç kësaj, në 2016, Misioni ka mbështetur përfshirjen e një analizë gjinore gjatë hartimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2016-2021.

Aftësimi i grave police për pozita komanduese

Në 2017, Misioni ka organizuar një trajnim me temë detyrat e komandantëve operacional për pjesëtarët e Shoqatës së Grave Police të Kosovës, si vazhdimësi e trajnimit për zhvillim të shkathtësive menaxheriale dhe udhëheqëse të mbajtur në 2016. Pjesëmarrëset u trajnuan rreth modeleve të vendim-marrjes në pozitë të komandantëve operacional, si të flasin para mediave, rëndësinë e krijimit të mirëbesimit me komunitete, si dhe mënyrat e hartimit të planeve operative për adresimin e incidenteve kritike. Në përmbyllje të këtij cikli trajnimesh, Misioni do ta ofrojë modulën e tretë në 2018 që ngërthen një program pune praktike jashtë vendit për zyrtarë të larta policore, të cilat i kanë ndjekur modulet e trajnimit në 2016 dhe 2017. Shoqata e Grave Police të Kosovës do të vazhdojë të jetë partner strategjik për Misionin.



Qasja e barabartë e grave në të drejta pronësore

Të vetëdijshëm rreth kufizimeve për zotërim të barabartë të pronës nga dy gjinitë, në 2016 Misioni ka mbajtur tri tryeza diskutimi me 80 përfaqësues/e të sektorit të drejtësisë për t'i angazhuar në ngritje të vetëdijes dhe respektimit të të drejtave të barabarta të grave në pronë, banim dhe trashëgimi. Misioni i ka mbështetur këta/o pjesëmarrës/e edhe në organizimin e vizitave informuese me përfaqësues/e të organizatave për të drejta të grave dhe të kuvendeve komunale. Në 2017, Misioni, në bashkëpunim me përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, ka mbajtur tryeza diskutimi për t'i vetëdijësuar komunitetet joshumicë rreth këtyre çështjeve. Në 2018, Misioni do të vazhdojë të punojë për ngritjen e vetëdijes në mesin e studentëve të juridikut.



Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal

Ndryshimet mbarë-shoqërore drejt barazisë gjinore kërkojnë përfshirje të perspektivës gjinore në buxhetet publike në nivel qendror dhe lokal. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë për Barazi Gjinore, Misioni i mbështet komunat që të aplikojnë instrumente praktike për buxhetim të përgjegjshëm gjinor që shpiejnë në buxhete publike më transparente dhe me një shpërndarje më të drejtë bazuar në nevojat e grave, vajzave, burrave dhe djemve. Si rrjedhojë e kësaj nisme shumëvjeçare, vihet re një rritje graduale e numrit të komunave që e zbatojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Në 2018, Misioni do vazhdojë të mbështes institucionet dhe palët përkatëse në vazhden e përpjekjeve të tyre për të përpiluar buxhete që u përgjigjen më tepër nevojave të të dy gjinive.

Barazia gjinore ka të bëjë edhe me burrat e djemtë

Burrat shumë shpesh lihen anash kur bëhet fjalë për punën rreth barazisë gjinore. Për ta ndryshuar këtë gjë, gjatë vitit 2016 dhe 2017 Misioni ka realizuar një projekt që ka angazhuar burra e djem në promovimin e barazisë gjinore. Misioni ka realizuar fushata vetëdijesimi dhe ka mbështetur organizatat e shoqërisë civile që punojnë me djem nëpër shkolla për t'i dhënë fund dhunës në baza gjinore. Veç kësaj, në partneritet me UNFPA-në, Misioni ka realizuar hulumtimin e parë gjithë-përfshirës të ekonomive familjare rreth qëndrimeve dhe praktikave të burrave për një varg temash të lidhura me barazinë gjinore. Rezultatet e këtij hulumtimi të titulluar Anketa Ndërkombëtare mbi Burrat dhe Barazinë Gjinore (IMAGES) do shërbejnë si bazë për avokim të bazuar në fakte e prova në 2018.

Fuqizimi i grave ndërmarrëse

Për ta inkurajuar dialogun mes komuniteteve dhe krijimin e kontakteve mes grave ndërmarrëse, në 2017 Misioni ka organizuar panairin tregtar në Prishtinë në të cilin kanë marrë pjesë 35 gra ndërmarrëse nga radhët e komuniteteve të ndryshme. Ndërmarrëset kishin mundësinë që t'i ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre jashtë vendbanimeve të tyre. Para panairit të tregtisë, po të njëjtat gra i kanë vijuar gjashtë trajnime rreth hartimit të planeve të biznesit dhe projekt-propozimeve, gjatë së cilës kohë kanë fituar njohuri dhe shkathtësi për mënyrën e aplikimit për fonde për zgjerim të bizneseve të tyre. Në 2018, Misioni do të vazhdojë të mbështes fuqizimin ekonomik të grave përmes aktiviteteve të ndryshme.

Misioni i OSBE-së bashkëpunon ngushtë me institucionet qendrore dhe lokale, organizatat për të drejtat e grave dhe organizata tjera të shoqërisë civile, partnerë ndërkombëtarë si dhe drejtpërdrejt me gra, vajza, burra e djem për t'i kontribuar ndryshimeve transformuese shoqërore me qëllim rritjen e barazi gjinore.

Duke marrë për bazë Planin e Veprimit të OSBE-së për promovim të barazisë gjinore 2004, ne zbatojmë aktivitete që mbështesin hartimin e legjislacionit dhe politikave gjithëpërfshirëse, fuqizimin e mekanizmave institucionalë për barazi gjinore, rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe politike, parandalimin dhe dhënien fund të dhunës në baza gjinore, fuqizimin e grave në sferën ekonomike, dhe promovimin e rolit të tyre në dialogun pas konfliktit.

Përveç aktiviteteve të dizajnuara enkas për të fuqizuar gratë, vajzat, burrat dhe djemtë, çështjet gjinore i kemi inkuadruar në të gjitha programet tjera të Misionit.

Gjatë përgatitjes së projekteve merren parasysh ndërthurjet mes gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, klasës shoqërore dhe karakteristikave tjera personale.

Mësoni më shumë rreth punës së OSBE-së për barazinë gjinore në

osce.org/gender-equality

osce.org/mission-in-kosovo/gender-equality

Na ndiqni në

facebook.com/oscekosovo

twitter.com/oscekosovo

instagram.com/oscekosovo

youtube.com/oscekosovo

